



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Ne baze të nenit 11 dhe 12, paragrafi 2, shkronja (d), lidhur me nenin 17, të Ligjit Nr. 03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 15, lidhur me nenin 16 dhe 17, të Ligjit Nr. 03/L-164 për finacimin e programeve të veçanta të banimit, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 67/2010”, e konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ Nr.19/2010 për përmbajtjen e bonus banimit dhe nenit 15, lidhur me nenin 29, paragrafi 2 pika (d) të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën,-----, miraton këtë:

Projekt-V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim përcaktohet vlera e bonus banimit dhe atë 40% e shumës së qirasë minimale të banesave në tregun e lirë në territorin e Komunës së Suharekës për vitin 2023.

Neni 2

Përfitues të bonus banimit për vitin 2023 do të jenë 7 (shtatë) familje dhe këto kategori të familjeve që mund të përfitojnë nga bonus banimi i programit të veçantë të banimit janë; 1. Familjet që nuk kanë banesë apo shtëpi në pronësi individuale dhe 2. Familjet që posedojnë sipërfaqe banimi nën normat e banimit, të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike.

Neni 3

Për zbatimin këtij vendimi kujdeset, Kryetari i Komunës, përkatësisht Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqene sociale në bashkëpunim me Drejtorinë për urbanizëm dhe planifikim në Komunën e Suharekës.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-_____
Më datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI